

# ARISE

Iniciativa për Uljen  
e Pabarazisë në Arsim

---

**Udhëzues për Politikat**

**Forcimi i përfshirjes  
së prindërve dhe komunitetit për  
një arsim cilësor, gjithëpërfshirës  
dhe të barabartë**

Republika e Shqipërisë

Tiranë, 2023

## **ARISE**

Iniciativa për Uljen e Pabarazisë në Arsim

Udhëzues për Politikën: Forcimi i përfshirjes së prindërve dhe komunitetit për një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë

### *Botuesi*

Qendra "Fëmijët Janë e Ardhmja" (FJA)

Rruga "Ibrahim Kodra", 1019 Tiranë – Shqipëri

[contact@cafalbania.org](mailto:contact@cafalbania.org)

[www.cafalbania.org](http://www.cafalbania.org)

### *Për botuesin*

Rozeta Hoxhallari

### *Autore*

Rozeta Hoxhallari

Griselda Zisi

Itena Hoxhallari

### *Metodologjia*

Network of Education Policy

Centers

Lana Jurko

Iva Perković

### *Dizajni*

Katarina Velan

*Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.*

*Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

# Tabela e përmbajtjes

---

Begraund	2
Procesi i Hartimit të Udhëzuesit për Politikat	3
Rëndësia e Përfshirjes së Prindërve dhe e Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet	4
Situata Aktuale dhe Çështjet Kryesore në Shqipëri	6
Qëllimi i Përgjithshëm dhe Objektivat Specifikë	10
Objektivi Specifik 1	11
Objektivi Specifik 2	13
Objektivi Specifik 3	15
Objektivi Specifik 4	16
Objektivi Specifik 5	20

# Begraundi

---

## Rreth Projektit

“Iniciativa për Uljen e Pabarazisë në Arsim” (ARISE) është një projekt rajonal, i financuar nga Komisioni Europian/Bashkimi Europian që po zbatohet në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi nëpërmjet një partneriteti midis organizatës Fëmijët Janë e Ardhmja (FJA)-Shqipëri, Qendrës Arsimore të Kosovës (KEC)-Kosovë, Rrjetit të Qendrave të Politikave Arsimore (NEPC)-Kroaci; Universitetit Sabancı Egitim Reformu Girisimi - Turqi; Qendrës për Politika Arsimore - Serbi; ProMENTE për hulumtime sociale dhe Qendrës për Iniciativa Arsimore Hap pas Hapi – Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Fondacionit për Nisma Arsimore dhe Kulture “Hap pas Hapi” – Maqedoni e Veriut.

Projekti synon të mbështesë përfshirjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik duke ngritur partneritete kombëtare dhe rajonale të organizatave të shoqërisë civile nga gjashtë vendet e lartpërmendura.

Nëpërmjet angazhuar në advokim dhe dialog konstruktiv për politikën me qeveritë, ai përpiqet të rrisë ndërgjegjësimin e aktorëve të arsimit, si edhe me ndërhyrjet pilot që synojnë nxënësit me SSE të ulët në nivel shkolle.

## Rreth FJA-së “Fëmijët Janë e Ardhmja”

Organizata “Fëmijët Janë e Ardhmja” (FJA) ka punuar rreth 15 vjet për shkolla më të hapura, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, si edhe për një sistem arsimor cilësor, gjithëpërfshirës e të barabartë në Shqipëri. Në programin e saj të arsimit, FJA ka qenë shumë e fokusuar në përmirësimin e lidershit të shkollës dhe cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve, zhvillimin e një kulture shkolle dhe politikash gjithëpërfshirëse, duke përfshirë Programet e Zhvillimit të Shkollës, forcimin e strukturave të brendshme të shkollës, pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe të të rinjve, forcimin e përfshirjes së prindërve dhe Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet (PSHFK).

# Procesi i Hartimit të Udhëzuesit për Politikat

Ky Udhëzues për Politikat, i cili u hartua nëpërmjet një procesi konsultimi gjithëpërfshirës me aktorë të ndryshëm, është produkt i përpjekjeve të shumta në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal në kuadër të projektit ARISE.

Këto përpjekje përfshijnë takime të Koalicionit Kombëtar të Politikave, të krijuar në kuadër të projektit me përfaqësues nga institucionet arsimore kombëtare dhe vendore, drejtoritë e shkollave përfituese, Rrjeti Rajonal i Prindërve, Organizata të Shoqërisë Civile, ekspertë të Arsimit dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm me mbështetjen e përfaqësuesve të FJA-së.

Gjithashtu, u realizuan një studim/raport kombëtar, një përmbledhje për politikën dhe një studim/raport krahasues rajonal që paraprinë Udhëzuesin për Politikën, si mjete për vlerësimin e sfidave për t'u trajtuar në nivel politikash.

Një seri takimesh, workshopesh dhe konsultimesh u zhvilluan me aktorë të ndryshëm në nivel shkolle, komuniteti dhe vendi. Po kështu, u realizuan edhe aktivitete të tjera të rëndësishme rajonale, si:

workshope shkëmbimi eksperiencash, vizita studimore, takime të Komitetit Drejtues të Projektit dhe Laboratorë Politikash.

Nëpërmjet këtij dokumenti, synojmë të ofrojmë rekomandime praktike se si të kontribuojmë për një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë, pavarësisht nga Statusi i tyre Socio-Ekonomik ose karakteristika të tjera, dhe të forcojmë një kulturë shkolle demokratike nëpërmjet forcimit të përfshirjes së prindërve dhe bashkëpunimit të shkollës me familjet dhe komunitetin me fokus të veçantë prindërit dhe fëmijët me SSE të ulët.

## Kujt i drejtohet ky dokument?

Udhëzuesi për Politikën është për partnerët e projektit, koalicionin e politikave, institucionet dhe organizatat e tjera që punojnë në arsim, politikëbërësit, shkollat përfituese të projektit dhe shkollat e tjera që nuk përfshihen në projekt, si edhe ekspertët dhe aktorët e tjerë të interesuar për përmirësimin e përfshirjes së prindërve dhe komunitetit në zhvillimin e një arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.

# Rëndësia e Përfshirjes së Prindërve dhe e Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet

Ky Udhëzues për Politikën përqendrohet specifikisht në rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe PSHFK, si një nga elementët kryesorë të një kulture shkolle gjithëpërfshirëse dhe demokratike dhe të një arsimit gjithëpërfshirës dhe të barabartë që mbështesin përfshirjen, zhvillimin dhe suksesin e të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga Statusi i tyre Socio-Ekonomik ose karakteristika të tjera.

Studimet e kryera gjatë katër dekadave të fundit dhe përvoja jonë e punës prej më shumë se 15 vitesh me shkolla në rrethe të ndryshme të Shqipërisë kanë treguar se përfshirja e prindërve dhe bashkëpunimi i shkollës me familjet dhe komunitetin janë çelësi i suksesit të nxënësve dhe shkollës në tërësi.

Përfshirja e prindërve është e rëndësishme për të nxënësit e fëmijëve, qëndrimet e tyre ndaj shkollës dhe aspiratat e tyre dhe fëmijët janë nxënës më të suksesshëm në të gjitha nivelet e klasave, nëse prindërit e tyre marrin pjesë në shkollë dhe inkurajojnë arsimimin dhe të mësuarin në shtëpi, pavarësisht nga niveli arsimor ose klasa shoqërore e prindërve të tyre[1].

Për më tepër, partneriteti shkollë-familje-komunitet (PSHFK), i cili përbën nivelin më të lartë të përfshirjes reale të prindërve dhe komunitetit, **mund të përmirësojë klimën dhe programet e shkollës**, të ofrojë shërbime dhe mbështetje për familjen, **të forcojë aftësitë dhe liderhipin e prindërve**, të lidhë familjet me shkollën dhe komunitetin, si edhe ndihmon mësuesit me punën e tyre. Mbi të gjitha, ai i ndihmon të gjithë të rinjtë të kenë sukses në shkollë dhe më vonë në jetë [2].

[1] Epstein, J. L. (2001). School, Family, and Community Partnerships: Preparing Educators and Improving Schools. Westview Press, A Member of the Perseus Books Group

[2] Po aty

Ndaj, rritja e përfshirjes së prindërve dhe e bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet është thelbësor për trajtimin në mënyrë efektive të sfidave, me të cilat përballen nxënësit me SSE të ulët dhe grupet e tjera vulnerabël, duke krijuar një mjedis të favorshëm për mirëqenien dhe suksesin e tyre.

Megjithatë, përfshirja aktive dhe kuptimplotë e prindërve, si edhe bashkëpunimi e partneriteti i fortë midis shkollës, familjeve dhe komunitetit nuk mund të sigurohen pa një vizion të qartë, një strategji kombëtare, një leadership shkolle demokratik dhe bashkëpunues, mësues të përgatitur e gjithëpërfshirës dhe politika gjithëpërfshirëse në nivel shkolle.

Përveç rolit të padiskutueshëm të drejtuesve të shkollave, vizionit, besimeve, vlerave dhe praktikave të tyre, mësuesit janë agjentët kryesorë të ndryshimit. Ata luajnë një rol kyç në përfshirjen e prindërve dhe në ngritjen e forcimit e strukturave të tyre përfaqësuese në shkolla, të cilat janë mekanizmat më të rëndësishme institucionale që mund të sigurojnë nivele më të larta pjesëmarrjeje si partnerë realë.

Më konkretisht, studimet theksojnë se, kur mësuesit, të cilët kanë qëndrime pozitive ndaj prindërve, e bëjnë përfshirjen e prindërve pjesë të praktikës së tyre të rregullt mësimore, prindërit rrisin ndërveprimet e tyre me fëmijët e tyre në shtëpi, ndihen më pozitivë për aftësitë e tyre për të ndihmuar fëmijët e tyre, i vlerësojnë mësuesit më pozitivisht, dhe, mbi të gjitha, nxënësit përmirësojnë qëndrimet e tyre ndaj shkollës dhe arritjet e tyre [3]. Për më tepër, sipas Epstein dhe Douber (1989) [4], qëndrimet më pozitive të mësuesve ndaj përfshirjes së prindërve sjellin më shumë sukses në përfshirjen e prindërve që arrihen me vëshirësi.

Ndaj, për të siguruar një përfshirje aktive dhe cilësore të prindërve në arsimimin e fëmijëve të tyre, veçanërisht të atyre me SSE të ulët dhe grupeve të tjera vulnerabël, si dhe një PSHFK të fortë, është e domosdoshme një qasje strategjike në nivel kombëtar, rajonal dhe në nivel shkolle, e shoqëruar me mbështetje të drejtpërdrejtë dhe mentorim për zhvillimin dhe zbatimin e Programeve gjithëpërfshirëse të PSHFK në bazë shkolle.

[3] Po aty.

[4] Epstein, J. L., and S. L. Dauber. (1989). Teacher attitudes and practices of parent involvement in inner-city elementary and middle schools. CREMS Report No 32. Baltimore: John Hopkins University, Center for Research in Elementary and Middle Schools.

# Situata Aktuale

## dhe Çështjet Kryesore në Shqipëri

Siç theksohet në raportin kombëtar të përgatitur në kuadër të projektit ARISE, janë bërë përmirësime në arsim për sa i përket kuadrit ligjor dhe zhvillimit të politikave si edhe iniciativat e reja të reformave [4].

Janë ndërmarrë një sërë reformash që synojnë një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, ndërkohë që politikatat kombëtare janë në linjë me objektivat europiane dhe globale. Kuadri relativisht i ri i kurrikulës së bazuar në kompetenca është shoqëruar me standarde më të larta për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave.

Aktualisht, kuadri ligjor kombëtar dhe politikatat arsimore vënë një theks të veçantë në përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në jetën e shkollës, si edhe në forcimin e lidërshiptit dhe të strukturave të brendshme të shkollës.

Më konkretisht, ligji për sistemin arsimor parauniversitar 69/12 me ndryshime (2015 dhe 2018), Strategjia Kombëtare e Arsimit (2021-2026)[1] dhe dokumente të tjera politikash, theksojnë rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe komunitetit në procesin e progresit, përmirësimit dhe demokratizimit të shkollës.

Prindërit janë **partnerët kryesorë të institucionit arsimor** që mund dhe duhet të përfshihen në mënyrë aktive në jetën e shkollës dhe të kontribuojnë në zhvillimin dhe suksesin e institucionit[1]. Ata mund të përfshihen dhe të përfaqësohen nëpërmjet Këshillit të Prindërve të Klasës dhe të Shkollës, Bordit të Shkollës dhe strukturave të tjera të rëndësishme.

[4] ARISE Action for reducing Inequalities in Education National Report for Albania

[5] Strategjia Kombëtare e Arsimit, 2021 - 2026

[6] Law on Pre-University Education system in the Republic of Albania 69/12 with amendments 56/2015 and 48/2018



Së bashku me mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe nxënësit, ata gjithashtu mund të përfshihen në planifikimin strategjik dhe të zhvillimit të shkollës dhe në rishikimin dhe përmirësimin e politikave në nivel shkolle; të iniciojnë, prezantojnë dhe të mbështesin aktivitete të ndryshme shkollore dhe jashtëshkollore; si edhe të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve, pra përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe shkollës [7]. Ligji për sistemin arsimor parauniversitar mbështet gjithashtu përfshirjen e prindërve në arsim në nivel rajonal dhe kombëtar nëpërmjet krijimit të Këshillave Rajonalë dhe Këshillit Kombëtar të Prindërve, të cilët, si struktura relativisht të reja, kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetje të vazhdueshme profesionale.

Një sërë iniciativash janë zbatuar në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në Shqipëri me mbështetjen e organizatave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me synimet dhe strategjinë kombëtare, së bashku me Programin Shkolla si Qendër Komunitare, të cilat kanë patur ndikimin e tyre pozitiv.

Pas gati 15 vitesh të punës së FJA-së me shkollat dhe komunitetet, vihet re një nivel më i lartë i ndërgjegjësimit mes prindërve dhe aktorëve të tjerë të shkollës për rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe komunitetit në përmirësimin e jetës së shkollës dhe cilësisë së arsimit dhe në arritjet dhe suksesin e nxënësve.

Shkollat përfituese të projektit kanë përmirësuar metodat e përfshirjes së prindërve, janë forcuar strukturat e brendshme të shkollës dhe është rritur përfshirja e prindërve dhe e komunitetit.

Megjithatë, në nivel kombëtar, ka ende “një hendek ...midis kuadrit ligjor...dhe zbatimit aktual të sistemit të decentralizuar” [8]. Këshillat e prindërve dhe strukturat e tjera të brendshme të shkollës në nivel kombëtar janë ende të dobëta dhe jo shumë të njohura dhe niveli i përfshirjes aktive të prindërve në jetën e shkollës dhe në bashkëpunimin shkollë-familje-komunitet nuk është ende i fortë.

[7] NEPC, 2016. Who rules the schools? - Mapping of the current school governance policies in the 10 countries, p.62

[8] Po aty.

Studimet dhe praktika tregojnë se, nëse Këshillat e Prindërve dhe strukturat e tjera të brendshme të shkollës zgjidhen përmes një procesi zgjedhor të gjerë, gjithëpërfshirës dhe demokratik, trajnohen mirë, mentorohen dhe mbështeten vazhdimisht, ata fitojnë kapacitetin për të përfshirë, përfaqësuar dhe mbështetur të gjithë prindërit, veçanërisht ata nga grupet vulnerabël dhe ofrojnë mbështetje të jashtëzakonshme për mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe nxënësit.

Kohët e fundit, për shkak të përmirësimit të legjislacionit dhe politikave kombëtare dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, vihen re përmirësime në drejtim të ndërgjegjësimit, forcimit të strukturave përfaqësuese të prindërve dhe përfshirjes dhe rolit të prindërve.

Megjithatë, shkollat nuk janë ende të përgatitura mirë për të siguruar një përfshirje aktive dhe kuptimplotë të prindërve përmes strukturave të tyre përfaqësuese dhe metodave të tjera dhe nuk zotërojnë plane strategjike apo politika gjithëpërfshirëse në nivel shkolle të Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet.

Mësuesit, nga ana tjetër, nuk janë ende të përgatitur mirë për të inkurajuar një përfshirje aktive të prindërve dhe nuk janë të gjithë të vetëdijsëm për metodat efektive të përfshirjes së prindërve dhe të një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Ndaj, për të arritur përmirësime të qëndrueshme dhe për t'i shtrirë praktikat pozitive në nivel kombëtar, nevojitet më shumë mbështetje nga autoritetet arsimore lokale dhe qendrore.

Duhet bërë përpjekje për ofrimin e mundësive për zhvillim të vazhdueshëm profesional të përshtatur sipas nevojave dhe për ngritjen e kapaciteteve për drejtuesit e shkollave, stafin e shkollës dhe strukturat përfaqësuese të prindërve, duke arritur bashkëpunim më të mirë midis shkollave dhe duke zbatuar programe më gjithëpërfshirëse të përfshirjes së prindërve dhe PSHFK.

Këto masa ka nevojë të ndërmerren si pjesë integrale e Programit të Zhvillimit të Shkollës dhe e një strategjie kombëtare të procesit të zhvillimit dhe demokratizimit të saj.

Prindërit kanë nevojë të rrisin ndërgjegjësimin e tyre dhe të kuptojnë më mirë rolin e tyre të rëndësishëm si partnerë të vërtetë në shkollë, të njihen me metodat efektive të përfshirjes së prindërve dhe, mbi të gjitha, të marrin udhëzime dhe mbështetje të vazhdueshme dhe të ndihen të mirëpritur e të vlerësuar për kontributin e tyre.

Përveç kësaj, shkollat kanë nevojë për një nivel më të lartë të autonomisë dhe një buxhet të dedikuar në mënyrë që të jenë në gjendje të zbatojnë me sukses Programet e tyre të Bashkëpunimit dhe Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet, si pjesë integrale e Programeve të Zhvillimit të Shkollës, bazuar në nevojat dhe interesat unike të komunitetit të shkollës.

# Qëllimi i Përgjithshëm dhe Objektivat Specifike

---

## Qëllimi i Përgjithshëm

Të sigurohen themelet e politikave, mekanizmat institucionalë dhe arsimtarë kompetentë që mbështesin dhe inkurajojnë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të prindërve në komunitetin e shkollës.

## Objektivat specifike

Të forcohen mekanizmat institucionalë në nivel kombëtar, rajonal dhe shkolle për një përfaqësim dhe rol më të lartë të prindërve.

Të iniciohet zhvillimi i politikave gjithëpërfshirëse kombëtare dhe në bazë shkolle që inkurajojnë e mbështesin përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunimin dhe partneritetin shkollë-familje-komunitet.

Të zhvillohet një mjedis shkolle mikpritës e gjithëpërfshirës, ku prindërit dhe të gjithë aktorët e tjerë ndihen të mirëpritur, të përfshirë në mënyrë aktive, të respektuar dhe të vlerësuar.

Të forcohen njohuritë dhe kompetencat e arsimtarëve për përfshirjen e prindërve dhe partneritetin Shkollë-Familje-Komunitet.

Të rritet ndërgjegjësimi i prindërve dhe i aktorëve të tjerë për rëndësinë e përfshirjes së prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre dhe metodat efektive të përfshirjes.

## Objektivi Specifik 1

Të forcohen mekanizmat institucionalë në nivel kombëtar, rajonal dhe shkolle për një përfaqësim dhe rol më të lartë të prindërve.

### Veprim 1: Forcimi i mekanizmave institucionalë kombëtarë:

- Rritja e kapacitetit dhe e rolit të Këshillit Kombëtar të Prindërve (KKP) nëpërmjet mundësive të ngritjes së kapacitetit dhe shkëmbimit të përvojave,
- Forcimi i lidhjes së KKP-së me Këshillat Rajonale të Prindërve (KRP) dhe Këshillat e Prindërve të Shkollave (KP) përmes mënyrave të ndryshme të komunikimit, konsultimit dhe bashkëpunimit.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar

### Veprim 2: Ofrimi i një niveli më të lartë autonomie dhe i mbështetjes financiare dhe profesionale për shkollat.

- Forcimi i përpjekjeve kombëtare drejt decentralizimit në arsim dhe forcimit të institucioneve arsimore,
- Sigurimi i një niveli më të lartë autonomie profesionale dhe financiare të drejtuesve të shkollave, mësuesve dhe strukturave të qeverisjes së shkollave në mënyrë që të mund të hartojnë dhe të zbatojnë Programet e PSHFK si pjesë integrale e Programeve të Zhvillimit të Shkollës, duke trajtuar nevojat dhe aspiratat e komuniteteve të tyre të ndryshme shkollore dhe duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit,
- Sigurimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare dhe teknike për shkollat që të mund të zbatojnë me sukses Programe gjithëpërfshirëse të PSHFK, të integruara në Programin e Zhvillimit të Shkollës dhe Planin Vjetor që synojnë një arsim cilësor, të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar

### **Veprim 3: Forcimi i KRP-ve dhe i lidhjes dhe bashkëpunimit të tyre me KKP dhe KP-të e Shkollave të rrethit/rajonit për të rritur rolin e tyre në përmirësimin e jetës së shkollës dhe cilësinë e arsimit.**

- Mbështetja e ngritjes së kapaciteteve të Këshillave Rajonale të Prindërve dhe komunikimit dhe bashkëpunimit me Këshillat e Prindërve të shkollave dhe Këshillin Kombëtar të Prindërve.

**Niveli i zbatimit:** Rajonal

## Objektivi Specifik 2

To initiate development of inclusive national and school-based policies that encourage and support parent involvement and school-family cooperation and partnership.

### Veprim 1: Rishikimi dhe përmirësimi i Kuadrit ligjor dhe i dokumenteve të politikave kombëtare përkatëse:

- Rishikimi i politikave dhe rregulloreve kryesore kombëtare në lidhje me përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në arsim dhe dhënia e rekomandimeve,
- Zhvillimi dhe përshtatja e politikave dhe udhëzimeve të reja për përfshirjen e prindërve, të tilla si: një Strategji Kombëtare për Përfshirjen e Prindërve dhe Programet në bazë shkolle të Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet si themele për një bashkëpunim dhe partneritet të fortë midis shkollës, familjeve dhe komunitetit që synon zhvillimin e shkollave më të hapura, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, si edhe një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik, ose përkatësi të tjera,

- Hartimi i dispozitave specifike, përmes bashkëpunimit ndërsektorial dhe lehtësirave, përmes të cilave punëdhënësit garantojnë kohën dhe lehtësitë për prindërit e punësuar për të marrë pjesë periodikisht në aktivitete të rëndësishme të shkollës së fëmijës së tyre,
- Njohja në nivel kombëtar dhe integrimi i **Ditës së Prindërve** në dokumentet arsimore kombëtare, për të nxitur dhe mbështetur zbatimin e saj në të gjitha shkollat e Shqipërisë.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar

### Veprim 2: Mbështetja e një studimi kombëtar mbi qëndrimet, njohuritë, besimet dhe praktikën e mësuesve për përfshirjen e prindërve.

- Gjetjet e siguruara nga studimi do të ndihmojnë në përmirësimin e kurseve aktuale të zhvillimit profesional dhe zhvillimin e trajnimeve të përshtatura, bazuar në nevojat specifike të mësuesve.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar

### **Veprim 3: Inkurajimi dhe mbështetja nga ekspertët e ZVA/DRAP-eve e zhvillimit të politikave dhe praktikave gjithëpërfshirëse në bazë shkolle.**

- Hartimi dhe zbatimi i Programeve të PSHFK në çdo shkollë,
- Zhvillimi dhe zbatimi i iniciativave të ndryshme të shkollave, organizatave jofitimprurëse, ekspertëve të arsimit dhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve, si dhe studimin dhe publikimin e materialeve mbështetëse (të tilla si: Manuali për zhvillimin e Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet, Manuali për funksionimin e Këshillave të Prindërve me informacion ndihmës për prindërit dhe Këshillat e Prindërve në të gjitha nivelet, mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, autoritetet arsimore dhe aktorë të tjerë të lidhur me arsimin).

**Niveli i zbatimit:** Rajonal



## Objektivi Specifik 3

Të rriten njohuritë dhe kompetencat e arsimtarëve për përfshirjen e prindërve dhe PSHFK.

### Veprim 1: Përfshirja e kurseve për përfshirjen e prindërve dhe PSHFK në edukimin/përgatitjen e mësuesve.

- Forcimi i zhvillimit dhe integritit të kurseve specifike (për rritjen e përfshirjes së prindërve dhe PSHFK) në Programet e Edukimit të Mësuesve të Departamenteve Pedagogjike të Universiteteve përkatëse.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar

### Veprim 2: Ngritje e kapacitetit dhe zhvillim i vazhdueshëm profesional i arsimtarëve lidhur me përfshirjen e prindërve dhe PSHFK

- Mbështetja e kurseve të zhvillimit profesional të ofruara nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare për forcimin e kapacitetit të ekspertëve të DRAP/ZVA-ve, drejtuesve të shkollave dhe stafit pedagogjik për zbatimin e metodave bashkëkohore efektive të përfshirjes së prindërve dhe PSHFK.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar

### Veprim 3: Forcimi i ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimit të përvojave, të mësuarit mes kolegëve/bashkëmoshatarëve dhe bashkëpunimit ndërmjet shkollave të të njëjtit rreth nëpërmjet mbështetjes së ZVA, DRAP-eve, KKP dhe KRP-ve, Njësive të Qeverisjes Vendore, OJF-ve dhe aktorëve të tjerë.

- Është e nevojshme që DRAP/ZVA-të të ofrojnë mbështetjen e tyre zyrtare për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtuesve të shkollave dhe stafit pedagogjik.
- Është e nevojshme që DRAP/ZVA-të të mbështesin organizimin e takimeve të shkëmbimit të përvojave, workshopeve dhe eventeve të të mësuarit nga kolegët midis institucioneve arsimore në nivel rrethi (dhe madje edhe në nivele kombëtare e të tjera) për të shkëmbyer praktikat pozitive dhe sfidat e hasura dhe për të dalë me veprime të përbashkëta në të ardhmen, drejt zhvillimeve më të qëndrueshme.

**Niveli i zbatimit:** Rajonal

## Objektivi Specifik 4

Të zhvillohet një mjedis shkolle mikpritës e gjithëpërfshirës, ku prindërit dhe të gjithë aktorët e tjerë ndihen të mirëpritur, të përfshirë në mënyrë aktive, të respektuar dhe të vlerësuar.

### Veprim 1: Vendosja e përfshirjes aktive dhe kuptimplote të prindërve si një nga temat qendrore në programin e zhvillimit të brendshëm profesional të shkollës.

- Drejtuesit e shkollës dhe stafi pedagogjik ndajnë informacion të përditësuar, praktikat më të mira të përfshirjes së prindërve, si edhe sfidat e hasura dhe mësimet e nxjerra.
- Drejtuesit e shkollave investojnë në trajnimin e mësuesve në lidhje me përfshirjen e prindërve dhe mbështesin përpjekjet e tyre.

- Drejtuesit e shkollave ofrojnë mentorim dhe mbështetje për stafin e shkollës, strukturat përfaqësuese të prindërve dhe aktorët e tjerë mbi përfshirjen e prindërve, duke u fokusuar në rolet dhe përgjegjësitë e prindërve, përfitimet dhe sfidat, metodat dhe mjetet efektive të përfshirjes së prindërve, si edhe të drejtat dhe detyrimet ligjore.

**Niveli i zbatimit:** Lokal

## **Veprim 2: Forcimi i politikave gjithëpërfshirëse në bazë shkolle, duke përfshirë zhvillimin e Programeve gjithëpërfshirëse të Partneritetit Shkollë-Familje-Komunitet.**

- Meqenëse përfshirja e prindërve nuk mund të jetë e suksesshme duke u bazuar vetëm në iniciativat individuale dhe praktikat sporadike të disa mësuesve, ajo duhet të bazohet në një program të mirëfilltë gjithëpërfshirës të partneritetit shkollë-familje-komunitet, ku integrohen të gjashtë llojet e përfshirjes së prindërve dhe komunitetit dhe përcaktohen qëllime strategjike për t'u arritur.
- Drejtorët e shkollave, në bashkëpunim me mësuesit, prindërit dhe nxënësit, punojnë së bashku për hartimin e programeve gjithëpërfshirëse të përfshirjes së prindërve dhe partneritetit shkollë-familje-komunitet dhe për zbatimin e tyre të suksesshëm, monitorimin dhe rishikimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme, duke pasur nxënësit në zemër të të gjithë procesit.

- Zhvillimi i kanaleve të komunikimit efektiv me prindërit dhe familjet e fëmijëve, duke forcuar komunikimin e dyanshëm (shkollë-familje-shkollë), i cili është thelbësor për suksesin e përfshirjes së prindërve dhe bashkëpunimit të shkollës me familjet.

**Niveli i bashkëpunimit:** Lokal

### Veprim 3: Forcimi i mekanizmave institucionalë në nivel shkolle.

- Drejtuesit e shkollave dhe mësuesit duhet të mbështesin forcimin e kapaciteteve dhe rolit të strukturave të rëndësishme të brendshme të shkollës, përfaqësuese të prindërve, si: Këshillat e Prindërve të Klasave dhe të Shkollës dhe Bordi i Shkollës për të inkurajuar dhe siguruar rritjen e përfshirjes së prindërve në procesin e vendimmarrjes dhe në të gjithë jetën e shkollës, duke iu ofruar vëmendje të veçantë prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta, me SSE të ulët dhe grupe të tjera vulnerabël,
- Mbështetja e zhvillimit të një procesi zgjedhor të hapur, gjithëpërfshirës dhe demokratik të Këshillave të Prindërve të klasave dhe të shkollës që inkurajon pjesëmarrjen dhe siguron mundësi të barabarta për të gjithë prindërit për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, pavarësisht nga niveli i tyre arsimor, struktura familjare ose statusi socio-ekonomik,
- Organizimi i Workshopeve informuese me mësuesit kujdestarë mbi rolin e tyre në lehtësimin e një procesi zgjedhor të hapur dhe gjithëpërfshirës në nivel klase, duke inkurajuar prindërit nga grupet vulnerabël,
- Trajnimi TiT i përfaqësuesve të zgjedhur të Këshillave të Prindërve (që do të përsëritet prej tyre me prindër të tjerë) për çështje të tilla si: Kultura e shkollës demokratike e gjithëpërfshirëse; qeverisja demokratike e shkollës, kuadri ligjor përkatës, roli dhe përgjegjësitë e KP-ve në nivel klase dhe shkolle, komunikimi efektiv dhe bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm; llojet e përfshirjes së prindërve; rëndësia e hartimit dhe zbatimit të një plani veprimi vjetor të KP-së që është në përputhje me Programin e Zhvillimit të Shkollës, misionin dhe vizionin e saj;
- Sigurimi i udhëzimeve për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Këshillave të Prindërve të Klasave dhe Këshillit të Prindërve të Shkollës, si dhe Këshillave Rajonale dhe atij Kombëtar të Prindërve, duke inkurajuar zhvillimin e iniciativave në nivel klase, shkolle dhe komuniteti në bashkëpunim me aktorë të tjerë për të rritur kapacitetin dhe rolin e tyre në gjithë jetën e shkollës.

**Niveli i zbatimit:** Lokal

## **Veprim 4: Zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse të shkollës dhe i lehtësirave për një përfshirje aktive e kuptimplotë të prindërve dhe aktorëve të tjerë.**

- Organizimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse me të gjithë shkollën, dedikuar prindërve si partnerë realë, si pjesë integrale e kulturës gjithëpërfshirëse të shkollës, duke përfshirë **"Ditën e Prindërve"**, **"Ditën e Kthimit në shkollë"**, ose **"Ditën e Fjalës së Mirë"** çdo vit, nëpërmjet një bashkëpunimi të fortë të drejtuesve të shkollave, stafit pedagogjik, Këshillave të Prindërve të klasave dhe të shkollës, Qeverisë së Nxënësve, prindërve dhe nxënësve të tjerë dhe aktorëve të tjerë,
- Krijimi i sallës/dhomës burimore ose i këndit të prindërve në çdo shkollë që do të ndihmojë në thyerjen e barrierave të pjesëmarrjes së prindërve të përjashtuar nga ana sociale, do t'i ndihmojë ata të komunikojnë, të punojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të ndihen të mirëpritur dhe pjesë e rëndësishme e komunitetit të shkollës.

**Niveli i zbatimit:** Lokal

## Objektivi Specifik 5

Rritja e ndërgjegjësimit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal (shkolle/komuniteti).

### Veprim 1: Rritja e ndërgjegjësimit.

- Të rritet niveli i ndërgjegjësimit dhe i të kuptuarit të përfitimeve/të mirave të përfshirjes së prindërve midis stafit të shkollës, prindërve, nxënësve dhe publikut të gjerë, në lidhje me rëndësinë dhe vlerën e përfshirjes së prindërve, rezultatet dhe ndikimet e saj pozitive, llojet e përfshirjes së prindërve dhe praktikave pozitive, si edhe metodat dhe mundësitë për përfshirje të qëndrueshme, aktive dhe kuptimplotë të prindërve.
- Përdorimi i platformave të ndryshme të medias dhe komunikimit për të arritur audiencë të ndryshme, të tilla si: televizioni, radioja, gazetatat, revistat, mediat sociale, faqet e internetit, posterat dhe fletëpalosjet, forumet, eventet dhe fushatat.

- Zhvillimi dhe ndarja e materialeve dhe burimeve lidhur me përfshirjen e prindërve, të tilla si: manuale, broshura, postera, video, podkaste, letra informuese dhe webinarë.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar, Rajonal, Lokal

### Veprim 2: Evente kombëtare të të mësuarit nga kolegët/bashkëmoshatarët.

- Evente që synojnë mbledhjen e aktorëve të ndryshëm me theks të veçantë në përfshirjen e përfaqësuesve të KKP-së, KRP-ve dhe KP-ve të shkollave të ndryshme, si edhe përfaqësuesve të Rrjetit të Prindërve.

**Niveli i zbatimit:** Kombëtar



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Network of Education Policy Centers

